



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Ministria e Punëve të Brendshme shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Shkencave Shoqërore
Institucioni	Ministria e Punëve të Brendshme
Nr. i Referencës	RN00010341
Kodi	RPC0004032
Data e njoftimit	02.11.2022
Afati për aplikim	23.11.2022 - 07.12.2022



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Mbështetja në hartimin e politikave, legjislacionit, strategjive dhe procedurave standarde për arsim në sektorin publik dhe privat;
- Mbikëqyrja dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit që rregullon fushën e arsimit në sektorin publik dhe privat si dhe zbatimin e standardeve për sigurimin e cilësisë së arsimit.
- Përgatitja e planeve vjetore dhe planet ad-hoc të inspektimeve pedagogjike të institucioneve edukative arsimore dhe procedura standarde lidhur me inspektimet e arsimit;
- Inspektimi i të gjitha institucioneve edukative dhe arsimore në sektorin publik dhe privat në aspektin pedagogjik lidhur me zhvillimin e procesit mësimor si dhe ekzaminimin e kushteve të punës;
- Shqyrtimi dhe vendosja e ankesave në shkallë të parë si dhe inicimi i procedurave adekuate administrative në mbrojtje të ligjshmërisë dhe rregullsisë të procesit mësimor dhe veprimtarisë së institucioneve arsimore;
- Verifikimi i saktësisë së dokumenteve të lëshuara nga institucionet arsimore publike dhe private si dhe sigurimi i pajtueshmërisë së tyre me legjislacionin në fuqi;
- Vlerësimi i programeve të kurrikulave, materialeve dhe mjeteve të konkretizimit për mësimdhënie dhe mësimnxënie si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime;
- Vizitat në objektet shkollore, dhomat e mësimit për të vëzhguar teknikat e mësimdhënies dhe për të vlerësuar performancën e mësuesve dhe rezultatet e arritura;
- Përgatitja e raporteve dhe dhënia e rekomandimeve për autoritetet arsimore në lidhje me ndryshimet dhe përmirësimet e mundshme në kurrikulat, metodat e mësimdhënies si dhe trajnimin e mësimdhënësve.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Kualifikime /trajtime të posaçme nga fusha përkatëse profesionale;
- Diplomë universitare të studimeve themelore dhe postdiplomike 300 kredi/ ECTS, (MA, MSC, MR) në fushën e arsimore dhe juridike;
- Përvoja e punës e kërkuar. Së paku pese 5 vite përvojë pune në fushën arsimore dhe juridike;
- Të mos ketë ushtruar funksione politike në tre (3) vitet e fundit;
- Të mos jetë i dënuar.



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës
RPC0000937	RN00007081	Inspektor i Arsimit	Profesional 1	8	Ministria e Punëve të Brendshme	SIA në Ferizaj / SIA - Ferizaj
RPC0000938	RN00007082	Inspektor i Arsimit	Profesional 1	8	Ministria e Punëve të Brendshme	SIA në Gjakovë / SIA - Gjakovë
RPC0000941	RN00007085	Inspektor i Arsimit	Profesional 1	8	Ministria e Punëve të Brendshme	SIA në Prishtinë / SIA PRISHTINË
RPC0000940	RN00007084	Inspektor i Arsimit	Profesional 1	8	Ministria e Punëve të Brendshme	SIA në Mitrovicë / SIA MITROVICË
RPC0000942	RN00007086	Inspektor i Arsimit	Profesional 1	8	Ministria e Punëve të Brendshme	SIA në Pejë / SIA - Pejë
RPC0000939	RN00007083	Inspektor i Arsimit	Profesional 1	8	Ministria e Punëve të Brendshme	SIA në Gjilan / SIA GJILAN
RPC0000943	RN00007087	Inspektor i Arsimit	Profesional 1	8	Ministria e Punëve të Brendshme	SIA në Prizren / SIA - Prizren

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim



- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit;
- Dëshmi që nuk ka një masë disiplinore për largim nga pozita e zyrtarit publik në pesë vitet e fundit (për kandidatët që janë zyrtare publik dëshmia lëshohet nga institucioni/et përkatës në të cilën ka punuar zyrtari në pesë vitet e fundit). Kandidatët e jashtëm paraqesin deklaratën me shkrim të vetë-nënshkruar, për të dëshmuar se ndaj tyre nuk ka pasur masë disiplinore të largimit nga pozita e zyrtarit publik në pesë vitet e fundit;
- deklaratë me shkrim që nuk ka ushtruar funksione politike në tre (3) vitet e fundit;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- Njohuri dhe përvojë në fushën e edukimit dhe arsimimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me arsimin
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

- *Të gjitha dokumentet e dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e konkurimit, kandidati, përmes aplikacionit, vetdeklaron se janë të vërteta dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e tyre. Deklarimi i rrejshëm paraqet shkak për përjashtimin nga procedura e pranimit.*

?



Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.
Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

